

(/)

KERKO

LAJME - VENDI (/../category/vendi) **FAMILJE (/../tag/familje)** **MASKA (/../tag/maska)** **MIRA RAKACOLLI (/../tag/mira rakacolli)** **ARTAN KONI (/../tag/Artan Koni)** **VDEKJE (/../tag/Vdekje)** **TEST (/../tag/test)** **TEMPORA (/../tag/tempora)** **QEVERIA (/../tag/qeveria)** **SHENASI RAMA (/../tag/Shenasi Rama)**

Sherr në Pustec, i riu kërcënon me armë babë e bir

05/08/2019 - 15:50



Babë e bir janë kërcënuar me një pistoletë sportive nga një i ri 27-vjeçar. Ngjarja ka ndodhur ditën e djeshme në fshatin Pustec në Korçë.

Policia thotë se në pranga u vu i riu me initiale M.B, banues në Bilisht.

"Ditën e djeshme në fshatin Liqenas, Pustec, shtetasi i mësipërm është konfliktuar për motive të dobëta me shtetasit N.S, 43 vjeç dhe shtetasin D.S, 15 vjeç, banues në Liqenas, (atë e bir), ku gjatë konfliktit shtetasi M.B, dyshohet se i ka kanosur të dy këta shtetas me një armë sportive tip pistoletë dhe më pas është larguar me shpejtësi me automjetin e tij", thuhet në njoftimin e policisë.

Pas marrjes së informacionit, policia thotë se e arrestoi 27-vjeçarin në qytetin e Korçës.

"Nga kontrolli fizik dhe kontrollit të ushtruar në mjet, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, një armë sportive tip pistoletë, me një krëhër me fishekë, të cilat ky shtetas i posedonte pa lejen përkatëse", thotë policia.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprat penale "Kanosja", "Vetëgjyqësia", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

/Ora News.tv/

(/)

Tags

SHERR (/../TAG/SHERR) PUSTEC (/../TAG/PUSTEC)

 (https://www.raiffeisen.al/alb/page/shkarko-dhe-aktivizo-app/?utm_source=Ora%20News&utm_medium=display&utm_campaign=DebitCardJune)

 ()



Video/ Serbët pushtojnë parlamentin, protestë kundër Vuçiç për masat kufizuese ndaj Covid-19 (video-serbet-pushtojne-parlamentin-proteste-kunder-vucic-masat-kufizuese-ndaj-covid-19)

Tërmeti, gazetarja: Qeveria thotë se ka ndihmuar 220 mijë familje, por ne na rezultuan 170 mijë (termeti-gazetarja-qeveria-thote-se-ka-ndihmuar-220-mije-familje-por-ne-na-rezultuan-170-mije)